



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Kuvendi

PROJEKTLIGJ

Nr. _____ / 2016

PËR

DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 9363, DATË 24.03.2005 “PËR MËNYRËN DHE PROCEDURAT E VENDOSJES DHE KALIMIT TË FORCAVE USHTARAKE TË HUAJA NË TERRITORIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, SI DHE PËR DËRGIMIN E FORCAVE USHTARAKE SHQIPTARE JASHTË VENDIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 12, pika 3, 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9363, datë 24.03.2005 “Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Titulli i ligjit, ndryshon dhe bëhet:

“Për dërgimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë jashtë vendit, si dhe për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë”.

Neni 2

Në nenin 1, togfjalëshi “... parimet e Organizatës së Atlantikut të Veriut...”, ndryshohet dhe bëhet “... Traktatin e Atlantikut të Veriut...”.

Neni 3

Në nenin 2, bëhet një ndryshim dhe një shtesë:

a) Në shkronjën “ç”, të pikës 1, pas fjalës “Pjesëmarrjen...”, shtohet togfjalëshi me këtë përmbajtje: “... e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë...”.

b) Pas shkronjës “ç”, shtohet shkronja “d”, me këtë përmbajtje:

“d) pjesëmarrjen e personelit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në strukturat e Organizatës së Atlantikut të Veriut, Bashkimit Evropian, organizatat ndërkombëtare dhe shtabet ushtarake ndërkombëtare”.

Neni 4

Në fund të pikës 1, të nenit 3, shtohen fjalët “... si dhe operacionet e vetëmbrojtjes kolektive, në kuadër të nenit 5 të Traktatit të Atlantikut të Veriut”.

Neni 5

Neni 4 ndryshohet, si më poshtë:

“Neni 4

Delegimi dhe pranimi i autoritetit të komandimit

1. Autoriteti kompetent sipas ligjit përkatës për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, për qëllime të bashkëpunimit ushtarak ndërkombëtar, mund t'i transferojë pjesë të autoritetit të vet komandantit ushtarak të strukturave të Traktatit të Atlantikut të Veriut, të një shteti të huaj ose të një organizate ndërkombëtare. Në të njëjtën mënyrë, autoriteti kompetent shqiptar mund të pranojë një autoritet, që i jepet nga një komandant ushtarak i strukturave të Traktatit të Atlantikut të Veriut, i një shteti të huaj ose nga një organizatë ndërkombëtare.

2. Autoriteti kompetent për dërgimin e njësive ushtarake në operacione ushtarake ndërkombëtare, në çdo rast, në aktin e dërgimit duhet të përcaktojë misionin dhe mandatin e këtyre forcave. Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, në zbatim të misionit dhe mandatit të përcaktuar, miraton rregullat e angazhimit për këto njësi ushtarake.”

Neni 6

Pika 5 e nenit 6, ndryshohet, si më poshtë:

“5. Këshilli i Ministrave me vendim mundëson lidhjen e një kontrate sigurimi në dobi të personelit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, që përmbush qëllimet e përcaktuara në nenin 3 të këtij ligji, e cila garanton pagesën në rast vdekjeje dhe dëmtimi shëndetësor. Kontrata e sigurimit bëhet edhe për personelin e Forcave të Armatosura pjesëmarrës në stërvitje sipas shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 2, si dhe për personelin e strukturave të përcaktuara në nenin 10 të këtij ligji, për kohën që dislokohet në zonë operacioni ushtarak”.

Neni 7

Neni 10, ndryshohet, si më poshtë:

“Neni 10

Emërimi i personelit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në strukturat e Organizatës së Atlantikut të Veriut, Bashkimit Evropian, organizatat ndërkombëtare dhe shtabet ushtarake ndërkombëtare.

1. Personeli i Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë emërohet në strukturat e Organizatës së Atlantikut të Veriut, Bashkimit Evropian, organizatat ndërkombëtare dhe në shtabet ushtarake ndërkombëtare, me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes.

2. Personeli i Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, i emëruar në strukturat e Organizatës së Atlantikut të Veriut, Bashkimit Evropian, organizatat ndërkombëtare dhe në shtabet ushtarake ndërkombëtare, në përmbushje të kërkesave të pozicionit të punës apo të komandës ku është angazhuar, mund të dislokohehet në zonë operacioni ushtarak, për periudha kohore jo më shumë se 30 ditë, me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes”.

Neni 8

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

K R Y E T A R I

ILIR META